



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON
PRIMLJENO:

13/03/2024

02/1396

M. M. R.

REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

PROCESVERBAL

i mbledhjes së-III- (tretë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

R E N D I D I T Ë S

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.11/265 datë:12.03.2024, për definimin e parcelës për ndërtimin e çerdhes në fshatin Bellanicë.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2023.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2023.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës për vitin 2023.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2024
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalid, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës për vitin 2024.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/466 datë:28.09.2023.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/619 datë:29.12.2023.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/84 datë:14.02.2024.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1409 datë:26.10.2023.

Mbledhja u mbajt me datë:19.03.2024 dhe filloi në ora:10:05. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 16 asamblistë, drejtori komunal: Hafir Rexha, Sylë Dukolli, Blerim Thaçi, Arbëreshë Krasniqi, zyrtar ligjor i Kuvendit Muhammed Morina, përfaqësuesi nga KDI, përfaqësuesi nga OSBE-së Salih Elshani dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z. Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e tretë të rregullt të Kuvendit të Malishevës. Prezent jemi 16 anëtarë, kemi kuorum dhe mund të vazhdojmë më punimet e mbledhjes. Mungesën e ka konfirmuar Arlind

Morina, Zamire Morina, Nebih Bibaj, ndërsa me vonesë do të vijë Driton Kastrati. Hapi diskutimin jashtë rendit të ditës. Urdhëro, Amrush!

Amrush Helshani: Faleminderit, Kryesues!

Të nderuar drejtorë komunal dhe ju anëtarë të asambles!

Si anëtarë i asambles komunale të Malishevës, përfaqësues i qytetarëve të kësaj komune duhet të shpreh nevojen dhe kërkesën nga disa takime që kam mbajtur me disa qytetar dhe fermerë. Kam ividentuar kërkesa dhe nevoja për ndihmë në riparimin dhe mirëmbajtjen e serave të dëmtuara nga kushtet atmosferike, siq janë dëmtimet nga najlonet dhe foliet e mbulimit të serave. Në këtë konteks si përfaqësues i asambles kërkoj një përgjigje nga drejtoria e bujqësisë për mundësitë për të ofruar mbështetje financiare ose burime alternative për ti mbuluar koston e nevojshme për riparimin dhe mirëmbajtjen e serave për fermerët tanë. Nëse drejtoria e bujqësisë nuk ka fonde që të ofroj një ndihmë të menjëherëshme, kërkoj që ajo të merr parasysh mundësinë e organizimit të një programi të mirëmbajtjes së serave në të ardhmen, duke përfshirë përdorimin e burimeve të komunitetit ose krijimin e partneriteteve me organizata të ndryshme për të siguruar mjetet dhe materialet e nevojshme për mirëmbajtjen e serave. Në fund besoj që kjo përkrahje do të sjellë përsfitime për bujqit, duke përfshirë rritjen e prodhimit bujqësor, rritjen e qëndrueshmëris ekonomike për fermerët dhe kontributin ne zhvillimin e qëndrueshëm të zonës rurale. Ju lutem drejtor i bujqësisë të merrni parasysh këtë kërkesë dhe të na informoni për hapat e mundshëm të marrjes së vendimeve për të adresuar këtë qëshjtë të rëndësishme. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Faleminderit, Amrush!

Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Faleminderit, Kryesues!

Të nderuar kolegë asambleistë, drejtorë komunal!

Unë shfrytëzoj rastin të ju uroj muajin e shenjtë të Ramazanit të gjithë qytetarëve të besimit islam dhe ju uroj agjërim sa më të lehtë.

Kam dy pyetje në këtë rast drejtorisë së shëndetësisë. Ditë më parë kam vërejtur në QKMF-ë që mungojnë bamat elementare duke filluar nga shiringat, infuzionet. Do ishte mirë të na jepet ndonjë përgjigje nga përgjegjësit e QKMF-së, cilat barna ju jepen falas qytetarëve të Malishevës. E dyta që më ka rënë në sy është se asnjëherë nuk i shohë mjekët e njejtë, por çdo herë kam parë mjek të ndryshëm, mjek të komunave të tjera. Më ka ngjasu sikur kjo qendër e mjekësisë familjarë të jetë një qendër e praktikantëve, që kjo është shqetësuese. Një rast konkret një punonjës teknik ditë më parë kam dëgju që ju është ngritur tensioni aty gjatë punës dhe nuk kanë arritur ta menjanojn atë shqetësim shëndetësor dhe janë detyru që ta përcjellin me ambullant në Prishtinë ta shqetësojnë pacientin. Kjo është serioze që përveq që po i fut në panik pacientët kjo kushton dhe shpenzimi karburanti. Këtu shihet qartë që nuk ka një seriozitet të punës së qendrën e mjekësisë familjare.

Një shqetësim tjetër, jemi rasti i vetëm në komunën e Malishevës që është një rast shumë i ndishum dhe sigurisht që do të marrim masa sipas Ligjeve në fuqi te drejtoria e financave. Kjo drejtori e financave sigurisht që ka dalë komplet prej binarëve, dhe kjo drejtori konkretisht drejtori bashkë me kryetarin këta nuk njohin vendime që dalin nga kuvendi, këta nuk njohin Ligi dhe Rregullore që janë në fuqi, këta veprojnë vetëm sipas tekave të tyre që është vërtetë për të ardhur keq. Këta nuk janë duke e ditur që me këto veprime janë duke e shkel Ligjin. Profesori i nderum Blerim Thaçi, e din shumë mirë se sa dëmtohet buxheti i qytetarit nga përmbarusit. Tani e kanë bërë si praktik që qdo mjet që duhet me u pagu vetëm përmes përmbaruesit, vetëm përmes gjykatës këtë formul e kanë gjetë dhe nuk merren për bazë. Këtu një

vërejtje e kam shumë të madhe dhe një shqetësim dhe ndaj kryesuesit të kuvendit z.Thaçi, që është shumë pasiv, shumë neglizhent dhe nuk e ushtron detyrën e tij që ja garanton dhe ja siguron Ligji dhe Rregulloret në fuqi. Kjo është shqetësuese, mirëpo ne do të marrim hapa të mëtutjeshëm dhe do ju drejtorohemi mekanizmave të tjerë. Pasi ta përfundojmë ne, siq i kanë përfundu të tjerët me përmbarues e me gjykata, ne do të vazhojmë dhe me kallëzime penale dhe dikush do të jep llogari për qdo cent, sepse këto janë taksa të qytetarëve të komunës së Malishevës. Unë po kërkoj vetëm zbatim të vendimeve që dalin nga ky Kuvend. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!

Unë kam tre qështje që dua ti ngris dhe shpresoj të marr përgjigje. Pastrimi i deponive ilegal, tek hyrja në fshatn Senik janë dy deponi të mbeturinave. Sigurisht është shqetësuese dhe po besoj që ka edhe të tilla dhe në fshatrat tjera. A është momenti i fundit që me reagu, me fillu me i pastru dhe me i ndëshku njerëz që hedhin mbeturina. Ne si Kuvend kemi marrur një vendim ku është lokacioni i përshtatshëm për hedhjen e tyre.

Qështja e përdorimit të veturave zyrtare. Unë sa e kuptoj vetëm kryetari dhe me një vendim dhe kryesuesi i kuvednit jashtë orarit të punës e kanë përdorimin e veturave zyrtare, ndërsa kur e shohim më vonë tek Raporti financiar shihet që është trefishu shuma e karburantit dhe riparimeve të automjeteve. Kush tjetër ka të drejtë me e shfrytzu veturën zyrtare, kuptohet veq ndonjë rast që është i jashtëzakonshëm. Në qarkullim po shohë dhe shumë drejtorë të tjerë, zyrtarë dhe pas orarit, që i përdorin dhe për nevoja personale, që nuk kanë të bëjnë fare me punën ne komunë.

Tani jemi në prag të regjistrimit civil, dua ta di sa jemi përgaditë si komunë mos me dështu ky proces, sepse do të varet shumë në dekadën e ardhshme qoftë buxheti, investimet kapitale ka me na diktua shumë dhe numri sa kemi me dalë në këtë regjistrim civil. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Përshëndetje për të gjithë!

Nuk po dua ta luaj rolin e mbrojtësit, por si kërkesë ishte pak përtej kapacitetit dhe kompetencave të drejtorisë së bujqësisë. Amrush, qëllimi i subvensionimit të fermerëve është që ata me i ndihmu për me i ngrit kapacitetet e tyre në mënyrë që nga ky subvensionim, ata me i zhvillu në një farë kuptimi aktivitetetin e tyre bujqësor në mënyrë që me gjerneru të ardhura dhe përmes atyre të ardhurave ata me funksionu. Për mendimin tim është kërkesë shumë e madhe me i kërku Drejtorisë së Bujqësisë me shku me ju riparu serat.

Alban, për barnat esenciale është e vërtetë ka mungesë të jashtëzakonshme. Në QKMF me sa kam informacion këto barnat esenciale apo lista e këtyre barnave nuk është kopetencë e komunës por është kopetencë e Ministrisë së Shëndetësisë, ku ata i furnizonë gjitha institucionet shëndetësore me listën e barnave esenciale. Cilat janë përpjekjet, shkresat, komunikimi i QKMF-së, që i kanë bërë Ministries së Shëndetësisë për me u pajis është një qështje tjetër.

Sa i përket çështjes së ekzekutimit të pagesës së anëtarëve të kuvendit, unë e konsideroj që kjo pjesë veç e ka kaluar çdo limit për shkakun se një vendim i kuvendit të komunës është i plotë fuqishëm pavarësisht Rregulloreve që janë atje. Nëse i referohemi rregullave të Ligjit të ri të pagave, aty thotë që paguhen vetëm komitetet e përherershme, që ka qenë dhe në atë kohë e njëjta përmes listës së pagave. Në kuadër të planit kontabël të shtetit ose të Republikës janë të planifikuar dhe kodet ekonomike për këshilldhënje. Unë kam informacion që gjatë vitit 2023, Komisioni i Aksionarëve për ndërmarrjen publike stacioni i autobusëve është paguar komplekt, që do të thotë që edhe brenda këti komisioni dy prej

anëtarëve janë paguar në baza të rregullta ndërsa njëri është pagu më vonë. Në qoftëse ka shkelje të Ligjit për me i pagu këto Komisione, atëherë unë konsideroj që është dashur mos me e pagu asnjë. Por, në qoftëse ekziston një vijë ose një mënyrë se si janë pagu ose si paguhen këto, atëherë është dashur me i pagu të gjitha pa dallim qfarë komisioni apo komiteti është i formun nga Kuvendi.

Ajo që ishte me vend ngritja me vend qështja e regjistrimit të popullsisë, me të vërtetë është një qështje shumë e ndieshme duke e pasur parasysh se regjistrimi i popullsisë ka ndikim të drejtpërdrejtë me ndarjen buxhetore në nivel komunal. Unë i inkurajoj jo vetëm ata që janë të përgjedhur për me i kry këto aktivitete, mirëpo gjithsecili prej neve në mënyrë jo të drejtpërdrejtë të kyqen dhe të asistojm që qdo qytetar i komunës së Malishevës qdo familje, qdo ekonomi familjare të regjistrohet në mënyrë që mos të penalizohemi për shkak të painformacionit apo për shkak të neglizhencës të ketë familje të cilat nuk janë regjistru në regjistrimin e popullsisë, duke e pas parasysh se regjistrimet e popullsisë bëhen 10 vjeçar, atëherë na për 10 vitet do ti vuajm pasojat e një muaji e gjysmë që është regjistrimi i popullsisë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Sylë Dukolli: Përshëndetje për të gjithë!

Serat kur dalin në prokurim e kanë një vit garancion nga operatori, kështu bëhet marrëveshja mes operatorit dhe prokurimit. Në atë vit, në qoftëse me fajin e vetë ati që e ka vendosur serën 1 vit munden me llogarit që vinë ja mirëmbajnë plasmasin, dmth atë llastikun që po thu ti.

Në kemi dhënë në dy forma dhe nga drejtoria e bujqësisë dhe nga organizata dhe organizata e ka marrveshjen me operatorin për një vit. Ai që e merr seren e merr për me riproduhu dhe në bazë të ati fitimi dhe e mirëmbajtjes si drejtori, dhe pse kemi kërkesa nga fermerët. I lus të gjithë me na kursy nga këto kërkesa që unë i kam të vazhdueshme.

Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Alban, më vjen keq që shprehesh ashtu, unë nuk kam ndonjë qështje që nuk dua ti paguj por ne e kërkojmë një formë se si duhet paguar. Ne jemi duke e bërë maksimumin dhe e kemi bërë. Kryetari ka nxjerr dhe vendime për ekzekutimin e atyre pagesave. Ka tre muaj që jemi duke e shqyrtau për me gjetë formën e pagesës, i kemi kompletu të gjitha mirëpo unë qeverin nuk mundem me detyru me i ekzekutu.

Alban Kastrati: Drejtor, sa mjete t'i ka marr vitin e kalun përmbarusi privat?

Blerim Thaçi: Vetëm për arsim i ka marr dhe ato nuk mundemi me i ndal.

Alban Kastrati: Pse nuk po i bënë pagesat me kohë, por po detyrohen me i dërgu përmes përmbarusit?

Blerim Thaçi: Nuk kemi mundur me i kry pagesat e shujtave. Kjo qështje është që 6-7 vite dhe nuk është vetëm tek ne. Unë po shpresoj që kanë me u ekzekutu dhe në qoftëse nuk bëhet unë me juve jam me i dërgu te përmbarusi vetëm le të kryehen pagesat.

Alban Kastrati: Pse disa komisione paguhen, disa jo?

Blerim Thaçi: Jemi në proces dhe me vendimin e kryetarit që e ka nxjerr për ekzekutim të këtyre vendimeve të kuvendit. Unë po shpresoj që ndoshta me fillim të prillit do të ekzekutohen. Kam planifik

mjete shtesë për qështjen e pagesave të komisioneve, 160,000.00E më shumë janë në kategorin e pagave, ato do të shkojnë në suficid nëse nuk paguhen këto komisione, sepse pikërisht për komisione i kemi ndar, mirëpo është qështje e ekzekutimit. Të gjitha dokumentet i kemi plotësuar, i kemi shënuar S email me Xhevrat Zejnullahun, me MAPL-në, me Ministrin e punëve të brendshme, të gjitha instancat i kemi shpenzu për me i ekzekutu.

Dikush po del me shit men dhe në emën të ekzekutivit dhe jep përgjigje në emër të ekzekutivit si kryhen këto punë. Le ta luan rolin secili në rolin e vetë. Për mua askush nuk ka nevojë me ju dhënë përgjigje asambleistave, sepse i jap vetë ato përgjigje.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!

Në seancën e fundit nuk kam qenë mirëpo i kam dëgju disa arsyetime prej shefit të NISMA-s te qështja e pagesave të Komisioneve. Drejtor, ne të mirëkuptojmë mirëpo duhet të na kuptosh dhe ti neve. Në qoftëse është e jashtëligjshme me u pagu komisionet, ne nuk bënë si kuvend me insistu diqka që është e jashtëligjshme, mirëpo ne kemi nxjerr vendime të kuvendit për me formu Komisione. Sot gjatë ditës kemi me diskutu për Raporte të kuvendit të cilat ne po i konsiderojm që janë të jashtëligjshme. Ne i kemi formu me vendim të kuvendit për me i ndihmu punës së kuvendit. Nëse drejtor është Ligji siq po thu ti ne mundemi me i shfuqizu me një vendim komisionet që i kemi formu dhe i lëjm vetëm dy Komitetet që janë të përherershme dhe dalim prej kësaj situate. Është e vërtet këtë që e tha Albani, që vitin e kalum ka Komision që është pagu, ndërsa komisionet tjera nuk janë pagu, aty është dilema jonë a kemi të drejtë apo jo.

Qështjet që i ngriten parafolësit, është mirë me u përgadit për regjistrim të popullsisë, sepse nëse nuk jemi përgaditë pasojat kanë me qenë afatgjate, sepse pikërisht buxheti bëhet në bazë të regjistrimit të fundit. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: E para kur je i papërgjegjshëm mos u mundo me gju dikun në papërgjegjësi.

E dyta ne jemi anëtarë të kuvendit dhe mundemi me diskutu në follore çka ne e konsiderojm që është e arsyeshme dhe nuk ka të drejt asnjë person me na diktua çka me fol, pavarsisht pozitës që e ka.

E treta, komunat i kanë paguar gjitha pagesat e komisioneve.

E katërtë pse janë pagu anëtarët e Komisionit të Aksionarëve stacioni i autobusëve, anëtarë i kuvendit Arlind Morina, Blerta Krasniqi janë pagu me rregull në vitin 2023, ndërsa Halil Morina që është kryesues i këti Komisioni është pagu jo me rregull meqenëse është pagu. Nëse ne jemi ardhur këtu për me ja tregu vendin dikujt tjetër ose me mësuar çka me fol, unë mendoj që kjo është qasje e gabuar dhe nuk i kontribuon procesit, askujt nuk i kontribuon. Por në qoftëse pasken të drejtë Arlindi dhe Blerta me i marr mjetet, pse nuk ka pasur të drejt me i marr dhe Albani, Valoni. Ligji është për të gjithë njejtë. Kryesues, kisha kërkuar nga ti me mbajt rendin sa më shumë dhe anëtarët e kuvendit me u trajtu si anëtarët e kuvendit, përndryshe në qoftëse vazhdon kjo situat unë po flas në emrin tim, unë i bojkotoj të gjitha mbledhjet.

Argjend Thaçi: Rendi mbahet sipas renditjes së kërkesës së fjalës dhe përderisa nuk fyhet, nuk ofendohet nuk llogaritet si prishje e rendit në asamble komunale. Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Unë thash që jemi për me i ekzekutu dhe kemi shfrytëzuar të gjitha instancat. Qështja e pagesës së Komisionit të Aksionarëve ka qenë për vitin 2022 dhe është kryer nga mallra dhe shërbime. Nuk është esenca e ndalimit të pagesave dhe nuk jam duke e mësuar askënd çka me fol, unë thash përkëtë përgjegjësin time jap përgjigjje unë, ndërsa sa i përket papërgjegjësisë time, ti ke qenë nxënësi im faleminderit nga ti.

Argjend Thaçi: 24 anëtarë jemi prezent dhe mund të vazhdojmë me seancën. Për rend të ditës kush e dëshiron fjalën? Urdhëro Urim!

Urim Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Sa i përket rendit të ditës propozoj që të largohet nga rendi i ditës Raporti i Shëndetësisë për arsyet të rregullimit të disa qështjeve.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Kryesues, pikat e fundit të cilat janë kërkesat për ndihma financiare të kalojnë të parat dhe pastaj vazhdojmë sipas renditjes që është.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Amrush!

Amrush Helshani: Kryesues, kërkoj që dhe Raporti për barazi gjinore të kthehet dhe një herë dhe të plotësohet, sepse ka nevojë për plotësim ndryshime.

Argjend Thaçi: Meqenëse në mbledhjen e kalume e kishim në rend të ditës raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar- dhjetor 2023 drejtori nuk ka qenë dhe e kemi shtyr përmblledhjen e ardhshme. Tani drejtori është prezent dhe kërkoj që kjo pikë të futet në rend të ditës. Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Përshëndetje për të gjithë!

Sa i përket rendit të ditës dua t'i parshtoj disa pytje. Planin e punës së Kuvendit ne bashkarisht e kemi miratuar dhe është mirë me respekt, për arsyet se kërkesat të cilat pak më parë i shtruam në dilem disa raporte dhe plane të punës së komisioneve, të cilat ne vazhdimisht po i diskutojmë a janë të ligjshme ato të paligjshme që përmua është e pa kuptimit, i kisha heq krejt, Malisheva nuk ka nevojë për Komisione të tillë. Nga muaji shkurt është plani i punës që e kemi miratuar bashkarisht, pse nuk ka ardhur plani i zyrës së Auditorit, i cili ka me i trajtu të gjeturat e vtitit paraprak.

Drejtoresha qenka këtu, nuk e di cila është arsyja që përsë deri tani nuk kemi raport të drejtoris së arsimit përfundimin e gjysmë vjetorit të parë.

Po hymë në tre mujorin e dytë dhe ne si të zgjedhurit e popullit nuk kemi plan të prokurimit. Sipas ligjeve plani i prokurimit duhet të vijë me u sqaru në muajin shkurt.

Dhe një pikë në seancën e kalume nuk kam qenë, mos e ngatronni raportin finanziar të drejtoris së financave me raportin e punës së kryetarit, i cili afatin ligjor e ka 31 marsin. Këto dy gjëra janë të ndara, të kundërtta.

Argjend Thaçi: E hedhi në votim propozimin e Urimit, që pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komiteti për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2023 të largohet nga rendi i ditës. Kush ëshë për?

Për: 15

Kundër:0

Abstenim:8

Kalojme te propozimi i Amrushit që Raportit të punës së Komiteti për Barazi Gjinore për vitin 2023 të largohet nga rendi i ditës. Kush është për?

Për:16

kundër:0

abstenim:5

E hedhim në votim propozimin e Vetonit, që pika numër 7, 8 dhe 9 të vendosen pas pikës së parë. Kush është për?

23 anëtarë prezent, me vota unanime miratohet propozimi i Vetonit.

Urdhëro, Muharrem!

Muharrem Morina: Afati i fundit për miratimin e Raportit finansiarështë 1marsi, është obligim ligjor me dal në kuvend mu shqyrto. Dallimi mes Raportit finansiar dhe Raportit të punës është i madh, sepse raporti finansiar paraqet pasqyrat financiare, të hyrat dhe shpenzimet që kanë ndodh në vitin 2023, ndërsa raporti i punës paraqet punën në gjitha dikastieret që kanë ndodh në administratën e kuvendit komunal që e paraqet kryetari.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Unë i ngrita disa qështje për të cilat nuk mora përgjigje. Sa i përket materialit unë personalisht po kam munges. Janë disa pika që nuk na kanë ardh dhe unë konsideroj që e kanë rëndësin e veqantë Plani i Auditimit, Raporti i DKA-së përfundimin e gjysmëvjetorit të parë dhe Plani i prokurimit që ne si të zgjedhurit e popullit nuk po dimë qka po ndodh. Këto kanë afat ligjor dhe kanë rëndësinë më të veqantë se sa këto raporte që po i konsideron të jashtëligjshme.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Muharrem!

Muharrem Morina: Plani i prokurimit së pari aprovohet nga kryetari i komunës, pastaj shkon në komisionin rregullativ të prokurimit publik dhe pas aprovimit vjen në asamble. Ligji për Vetëqeverisje Lokale nuk thotë me ardh në asamble, por thotë në Komitetin për Politikë e Financa, mirëpo është praktik e jona që e kemi sjellë dhe në asamble.

Plani i Auditimit- Auditori i brendshëm ose njësia për auditimin e brendshëm e ka për obligim planin me dorzu tek kryetari i komunës, jo në asamble, megjithatë nga praktika dhe planin e kemi sjellë këtu dhe plani do të vijë.

Argjend Thaçi: Kush është që si pikë e re e rendit të ditës të futet Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2023?

Për:17

Kundër: 3

Abstenim:3

Me 17 vota për, 3 kundër dhe 3 abstenime kjo pikë hynë në rend të ditës.

Shkojmë në votim për rendin e ditës. Kush është për këtë rend të ditës me ndryshimet e bëra?

Për:19

Kundër:0

Abstenim: 3

Kalojm në pikën e parë: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.11/265 datë:12.03.2024, për definimin e parcelës për ndërtimin e çerdhes në fshatin Bellanicë. Urdhëro, drejtoreshë!

Arbëreshë Krasniqi: Përshëndetje të gjithë!

Sot po ndihem mirë dhe besoj bashkë me mua dhe ju për mundësinë që do të krijojm një çerdhe publike në fshatin Bellanicë, duke qenë vazhdimësi e çerdheve publike të fshatrave të komunës së Malishevës. Çerdhja në Bellanicë është e pesta në komunën e Malishevës. Këto punë të mira nuk bënë pa juve, pa mbështetjen e asambles dhe pa mbështetjen e Ministries. Në komunën e Malishevës tre çerdhe të ndërtuara nga buxheti i komunës, dy në Malishevë dhe një në fshatin Kijevë, ndërsa çerdhet të cilat po mbështeten nga Ministria e Arsimit është çerdhja në fshatin Banjë dhe kjo në fshatin Bellanicë që pretendohet që Ministria ta ndërtoj nga themeli deri në përfundim. Të gjitha ato kriter që janë kërkuar nga Ministria, ne si drejtori i kemi plotësuar dhe ka mbetur dhe përcaktimi i lokacioni. Ne në fshatin Bellanicë kemi shkuar bashkë me përsaqësuesit e ministris, asambleisti Astrit Sertolli dhe jemi përcaktu me fshatarët për caktimin e lokacionit. Për fat të mirë aty kemi një parcelë e cila është në emër të shkollës dhe pjesa tjetër që duhet të lëviz në drejtë të kësaj parcele poashtu është pronë publike. Nuk kemi telashe për pronësi, por vetëm na duhet një miratim nga asambleja që kjo pronë publike dhe prona e shkollës të bëhen bashkë dhe të jetë një emërtim i vetëm që do të quhet çerdhja publike për fëmijë në fshatin Bellanicë. Çerdhet publike nëpër fshatrat kanë qenë dhe premtim elektorale, falë dhe mbështetjes së juaj dhe mbështetjes qytetare të Malishevës.

Shkolla e vjetër në Banjë kap vlerën mbi 300.000.000E, që nënupton dhe rregullimin e oborrit me gjithë infrastrukturën përcjellëse Ministria e Arsimit po e mbështet këtë dhe njëkohësisht jemi në fazën finale të çerdhes në fshatin Dragobil. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Astrit!

Astrit Sertolli: Përshëndetje për të gjithë!

Personalisht jam shumë i kënaqur me punën dhe angazhimin e drejtorisë së arsimit në Malishevë e posaqërisht drejtoreshës Arbëreshë Krasniqi që janë munduar që ky projekt të jetësohet. E falënderoj Ministrin që këtë premtim po na ndihmon me realizu, poashtu falënderoj dhe drejtorin për gjeodezi e kadastër të cilët kanë qenë qdo herë për kërkesat që i kemi bërë. Uroj gjithë fëmijët e fshatit Bellanicë dhe fshatrave përreth që do të janë pjesë e kësaj qerdhe. Besoj ë vota juaj do të jetë pro kësaj.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Fjoralba!

Fjoralba Hoxha: Përshëndetje për të gjithë!

Një frymëzim për Bellanicën dhe fshatrat përreth ndërtimi i çerdhes publike për fëmijë. Ndërtimi i kësaj çerdhe të re për fëmijë paraqet një investim të rëndësishëm në arsimin filletar të Bellanicës dhe të fshatrave përreth. Përveq osrimit të një mjedisi të sigurt dhe stimulus përfumim, kjo çerdhe do të ofroj dhe programe të pasura të arsimimit për të përgaditur fëmijët për udhëtimin e tyre në shkollën filllore. Ky projekt jo vetëm do të ndërtoj strukturën fizike të një çerdhe por dhe do të rriss ndërgjegjësimin përfundësinë e arsimit parashkollar dhe do të krijoj mundësi të reja për zhvillimin e fëmijëve tonë. Me ndërtimin e kësaj çerdhe shohim një hap të madh përpëra drejt një të ardhme më të ndritur për të gjithë

fëmijët e Bellanicës dhe fshatrave përreth. Duke e parë dhe vlerësuar rëndësin e këti projekti unë falënderoj drejtoreshën e arsimit dhe gjithë ata që kanë kontribuar që kjo çerdhe të ndërtohet në Bellanicë. Të nderuar anëtarë të asambles ju fitoj që të jepni votën e juaj pro caktimit të lokacionit.

Argjend Thaqi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: I përgëzoj gjithë qytetarët e fshatit Bellanicë të cilët po bëhen me një çerdhe të re, ku fëmijët e këti fshati dhe fshatrave përreth do ta kenë mundësin që të fillojnë edukimin e hershëm kjo falë iniciimit të kërkësave nga Drejtoria e Arsimit dhe bashkëpunimit me Ministrin e Arsimit, që i falënderojmë të dyat. Ky është shembulli tipik i një dikastieri të caktuar kur ka vullnet për me dërgu një qëshqje përpëra, kjo është bashkëpunimi është një shembull tipik si duhet me fuksionu. Jo me injorancë, por thjesht me komunikim me bashkëpunim.

Një organizatë krejtësisht tjetër ka arritur drejtoria e arsimit që me rregullu çerdhen në Banjë, me investim mbi 300.000.000E prej Ministrisë së Arsimit, plus me ndërtu një çerdhe të re për fshatin Bellanicë dhe adaptimit i shkollës së vjetër në fshatin Dragobil për me kriju si çerdhe për me i ndihmu dhe me i kontribu kësaj shoqërie. Është qëshqje vullneti si duhet me punu dhe sa duhet me qenë i përkushtum ndaj punës për të cilën je i thirrur.

Argjend Thaqi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Faleminderit, Kryesues!

Sigurisht dhe unë si anëtarë i kuvendit komunal po ndihem mirë për fillimin e procedurave të një projekti, i cili është shumë i mirëseardhur për qytetarët e Malishevës e veqanarisht të fshatit Bellanicë dhe fshatrave përreth. E tha dhe drejtoresha që ka qenë ndër premtimet elektorale ndërtimi i çerdhes në Bellanicë. Ju e keni parë projekt programin e PDK-së, jo vetëm gjatë fushatës elektorale por edhe gjatë kuvendit ne vazhdimisht kemi kërkua dhe kemi insistuar që të fillohet sa më parë procedura për ndërtimin e çerdhes në Bellanicë. Ne si grup i PDK-së e mbështesim një projekt të tillë dhe projekte të tillë që janë të këti niveli dhe që ju shërbejnë qytetarëve çdo herë janë të mirëseardhura dhe kanë mbëshitet e plotë nga Partia Demokratike. Shfrytëzoj rastin t'i përgëzoj dhe t'i uroj qytetarët e fshatit Bellanicë dhe të fshatrave përreth. Urime, shpresoj që projekti të filloj mbarë dhe të mbaroj mbarë!

Argjend Thaqi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Përshëndetje!

Sot e kemi një pikë me caktu lokacionin e një çerdhe në fshatin Bellanicë, që nënkuption dhe përfëmijët rrëth fshatit Bellanicë. Kjo tregon një gadishmëri dhe një aktivitet të mirë të Drejtorisë së Arsimit që e falënderoj dhe poashtu dhe akterieve të tjera siç është Ministria e Arsimit që e finançon këtë projekt dhe gjithë akterieve që kanë marr pjesë deri në një vendim që do të rezultoj me një punë të mirë përfëmijët tanë. Dhe çerdhja në Dragobil do ti plotëson nevojat e shumë fshatrave përreth kështu që Arbëreshë dhe atje mos me lënë anash sepse dhe ajo pjesë ka nevojë. Faleminderit!

Argjend Thaqi: Urdhëro, Agnesë!

Agnesë Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

Faleminderit shumë drejtoreshë për prezantimin, punën dhe bashkëpunimin e afërt me Ministrien e Arsimit. Unë kam dy pytje për ju. Kur mendohet me u finalizu çerdhja në fshatin Dragobil dhe për caktimin e lokacionit në fshatin Bellanicë a është marrë parasysh dhe udhëzuesi për normat dhe standartet

e hapsirave të objekteve parashkollore siç është e përcaktume me udhëzimin administrativ të Ministrisë së Arsimit?

Faleminderit!

Argjend Thaqi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Ne si grup e mbështesim kërkesën për fillimin e procedurave për çerdhen në Bellanicë. E falenderojm drejtoreshën që ka gjetur një gjuhë të mirëkuptimit dhe uroj që një shembull të tillë ta ndjekin dhe drejtorët e tjerë. Tani e kemi reportin financiar dhe nuk e pashë tek të hyrat vetanake nuk figuron fare participimi qytetar që bëhet për këta që i kanë fëmijët në çerdhe. Pse nuk është tek të hyrat vetanake kjo? A keni bërë kërkesë tjetër përveq Dragobilit, sepse e kemi fshatin Carrallukë, Drenoc deri tek Balinca që është e papërfshine. A ju keni drejtu tek Ministria një kërkesë që të paktën në Carrallukë ose Drenoc ta kemi një çerdhe.

Argjend Thaqi: Urdhëro, Amrush!

Amrush Helshani: Drejtoreshë, dua të ju përgëzoj për shfrytëzimin e mundësive të bashkëpunimit me akteriet relevant për ndërtimin e kësaj çerdhe. Bellanica dhe fshatrat përreth meritojnë një institucion të tillë dhe e ka mbështetjen e plotë. Unë kam një pyetje për drejtoreshën. Sa do të jetë kapaciteti i kësaj çerdhe, sa fëmijë planifikohen të pranohen?

Argjend Thaqi: Urdhëro, Burim!

Burm Paqarizi: Përvendetje për të gjithë!

Sot na ka ardhur një pikë e rëndësishme të cilën duhet me vlerësu dhe uroj që sa më shpesh të kemi kësot pikash që na rrisin dhe nivelin e punës, nivelin e bashkëpunimit që të kemi mundësi me të mëdha me ju ofru kushte sa më të mira qytetarëve të komunës së Malishevës. Uroj të gjithë banorët e fshatit Bellanicë dhe banorët e fshatrave përreth që kanë mundësi me shfrytëzu infrastrukturën për edukimin e hershmë përfëmijët. Ne si Parti Demokratike i mbështesim fuqishëm investimet e mira si në arsim dhe në fushat e tjera. Uroj që dhe në fshatin Dragobil të realizohet sa më shpejtë. Faleminderit!

Argjend Thaqi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gasli: Ne si LDK-ë e përkrahim si projekt dhe i gjithë projekti të tillë për ndërtimin e çerdhes në fshatin Bellanicë. Drejtoreshë, ne e kemi kaluar një Rregullore për formimin e bashkësive lokale dhe Bellanica është bashkësi lokale me fshatin Bardhë, Ngucat dhe në dokumentacion nuk e pash pëlqimin e kryesisë së bashkësisë lokale të këtyre fshatrave për lokacionin.

Argjend Thaqi: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Duke i pasur parasysh opinionet e juaja, ka qenë që ju nuk e njhni kryetarin e LDK dega në Malishevë, si po flet në emër të LDK-së.

Labinot Gasli: Asnjëherë nuk kam thënë që s'jam LDK-ë, mospajtime mundemi me pas me kryetarin, me kryesuesin mirëpo unë vazhdoj me qenë LDK-ë dhe kam të drejt me fol në emër të LDK-ës.

Argjend Thaqi: Urdhëro, Rukije!

Rukije Bytyqi: Përshëndetje për të gjithë!

Drejtoreshë, të përgëzoj për punën e mirë që po e bënë, sepse duke e shikuar Malishevën vetëm pak vite më herët e kemi parë që shumë nëna kanë sakrifikuar karrierën e tyre në mungesë të çerdheve dhe janë detyruar të rrinë në shtëpi që të merren me fëmijët. Falë punës së palodhshme që e ka bërë drejtoresha në bashkëpunim me ekzekutivin kanë arritur që sot këtë problem ta zhdukin pothuajse plotësisht. I përgëzoj dhe banorët e Bellanicës për çerdhen e re, gjithashtu dhe banorët e fshatit Dragobil që presin që shumë shpejtë dhe ata të bëhen me çerdhe. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Drejtoreshë, desha të falënderoj për gjithë punën dhe angazhimin që e ke bërë gjatë gjithë këtyre viteve që jemi në këtë mandat. Dua ta falënderoj dhe Ministri i Arsimit që na ka dhënë një përkrahje shumë të mirë dhe po vazhdon të na përkrahë falë iniciimit tuaj. Fshatin Bellanicë dhe fshatrat përreth i uroj për çerdhen e re dhe të ketë sa më shumë fëmijë që ta gëzojnë këtë çerdhe. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Faleminderit, Kryesues!

Drejtoreshë, përveq lavdatav që ju kemi dhënë dhe vazhdojmë të ju japim aty ku punoni. Si përfaqësues i qytetarëve, kam një shqetësim që nëpër rrjetet sociale kam parë që drejtori i shkollës së kompetencës me stafin e tij, prej 5-6 profesorëve shkon në bashkësinë islame të Malishevës dhe i uron rizgjedhjen kryetarit të bashkësisë islame. Kjo mua nuk më ka tingëllu mirë, mos janë dalë jashtë mandatit të tyre dhe jashtë procedurave të arsimit. Kërkoi një përgjigje që a është në rregull me ndodh një gjë e tillë dhe cili është mesazhi që u jepet nxënësve dhe qytetarëve që një drejtor shkolle bashkë me profesorë të shkojë dhe të bëjë këso veprime.

Zakonisht kemi pasur ankesa të shkollave konkretisht po lidhem me shkollën “Ibrahim Mazreku”, ku deri vonë nuk ka pasur fotokopje dhe arsimtarët kanë qenë të detyruar që të dalin me mjetet e tyre ato hartime apo fletushka me i fotokopju dhe me ju dërgu nxënësve.

E treta nuk po më pelqejnë që disa individë në shkollën në Drenoc-imami apo hoxha del në postime që sot e funizuam shkollën e Drenocit me një fotokopje që ndoshta nuk ka vlerë 30-40E dhe të bëhet këso marketinge. Nuk është e mirë kjo dhe nuk kemi nevojë ne dhe shkollat nuk janë institucione sociale.

Buxheti komunal ndahet për me i furnizu ose me i pajis me mjetet të nevojshme në këtë rast me aparatur. Kisha kërkuar me pas një kujdes dhe mos me qit institucionin arsimor në këtë rast edhe komunën edhe drejtorin e juaj në këso pozite aspak të lakkueshme. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtoresh!

Arbëreshë Krasniqi: Ju falënderoj dhe për mbëshetjen dhe për fjalët e mira që i thatë për drejtorin e arsimit dhe bashkëpunimit me dikastieret tjera. Komuna e Malishevës në çdo takim që paraqitemi ne është e dinjitetshme dhe unë jam e bindur që të gjitha kërkesat e drejtorisë së arsimit në drejtim të ministries kanë qenë të plotësuara në tërsi. Kërkesa e parë e drejtorisë së arsimit për me bërë një çerdhe ka qenë kërkesa për fshatin Carrallukë, bashkangjitur kësaj ka qenë kërkesa për fshatin Drenoc, pastaj Banjë dhe Dragobil. Ekspertët të cilët masin statikën e qëndrueshmërisë të shkollave të vjetra që të shëndrrohen në çerdhe nuk kanë pranu që shkolla e vjetër e Carrallukës dhe shkolla e vjetër Xhevë Krasniqi ne Drenoc të shëndrrohen në çerdhe, nuk ka pasur siguri statike që të investohet në këto dy objekte. Shkolla e vjetër në Banjë ka pasur një statik të qëndrushëm dhe ekspertët e ndërtimit kanë konstatuar që në këtë

objekt mund të vazhdohet me investim. E njëjtë ka ndodh dhe me shkollën e Dragobilit dhe aty është një statik e qëndrueshme sipas ekspertëve po dhe ajo është në fazën finale që të adaptohet në çerdhe përfmijë. Shkolla e vjetër e Banjës- numri i lindjeve në këtë fshat dhe fshatrave përreth e gjitha kjo e ka bërë që numri i fëmijëve të plotësohet që ky objekt të shëndrrohet në çerdhe.

Fotokopjet janë një shqetësim i vazhdueshëm dhe pothuajse kemi ardhur në fazën përfundimtare që atë kontratë komuna e Malishevës që atë operatorë ta shty në listën e zezë që i bie me vërejtjet me komentet tonë negative, me emailat e vazhueshëm që nuk ka plotësim të fotokopjeve me toner në shkollat e komunës së Malishevës, që për të cilën dhe administra dhe komuna janë ballafaqohet me situata të tilla. Ne nuk kemi kontrat në nivel të komunës por në nivel Republike që furnizon të gjithë institucionet në nivel të Republikës me letër me toner dhe me fotokopje ne asnëjëherë nuk jemi ndalë me vërejtje dhe me komentet negative. Unë kam telashe dhe me tabela të zeza, nuk kam të drejtë me furnizu shkollat përderisa e kemi një operator që përfshinë furnizimin në nivel të Republikës. Një gjë të tillë e keni parë në shkollën Ibrahim Mazreku, që vetë prindërit kanë marr iniciativë dhe e kanë realizu dërrasa të zeza, sepse nuk ta lejon ligji, nuk e kemi asnë mundësi me operu me një kontrat që e lidh komuna e Malishevës në këtë ras dhe me dërrasa të zeza, furizim me inventar, dhe me letër e toner sepse janë kontrata që janë lidh në AQP në kuadër Republike.

Agnesë minimalisht 15ari parcelë janë të kërkua të përdorit, e ne në këtë rast në parcelë i kemi 20ari që nënkuption dhe këndin e lodrave përfmijë dhe mundësi të rrethojave të oborrit të qerdhes.

Kapaciteti përfmijë unë mendoj që minimalisht do të jetë 80 fëmijë, mund të shkojë mbi 80 siq është në fshatin Banjë që është deri në 120 fëmijë. Në Bellanicë ende nuk jemi përcaktu mirëpo e kemi mundësin e përzgjedhjes se projektit. Ministria e arsimit fillimisht ka pasur kërkësë që klasat parashkollore në disa prej institucioneve tonë shkollore të shëndrrohen në qerdhe dhe një veprimitari të tillë drejtoria e arsimit nuk e ka pranu

Drejtoria e arsimit përgjatë dy viteve ka pranuar përkrahje dhe mbështetje qytetare të formave të ndryshme duke filluar nga lapsat kimikat, fletore qanta dhe ne për qdo moment u jemi falenderues dhe mirënjoyës të gjithë atyre që investojnë dhe ndihmojnë shkollat në komunën e Malishevës. Një prej rasteve të fundit është investimi i qerdhes në fshatin Kijevë në vlerë prej 8500E një prej donatorëve që ka kontribuar në riletat e qerdhes. Donatori tjetër është në vlerë 15.000.000E është në finalizim e sipër që të investoj në kuzhinën e qerdhes në Malishevë. Unë i falënderoj të gjithë ata që na kane ndihmuar në drejtim të shkollave dhe të gjithë inicuesit në bashkëpunim me komitetin e prindërvë që kanë investu në drejtim të institucioneve tonë shkollore, shembullin e tillë e kemi dhe në shkollën Ibrahim Mazreku. Kemi dhurimin e tri fotokopjeve në shkollën në Drenoc nga Osman Krasniqi që është sekretar në Bashkësinë Islame në Malishevë. Nazmi Zogaj është një prej personaliteteve ose drejtorëve që unë kam pasur fatin e mirë që ta kem drejtor s'akam qenë në qendër të kompetencës dhe jam e bindur që secili punëtor që punon aty ka të njëjtin respekt përfkëtë personalitet. A ka shkuar me i vizitu apo me ju uru, unë jam e bindur që ai ka shkuar në emrin e tij personal nuk ka shku në emër të drejtorit të shkollës nuk e di në qfarë orai kohor ka shku nuk e kam këtë informacion

Alban Kastrati: Në aspektin privat ti shko ku të duash nuk i intereson askujt, mirëpo të shikosh si institucion në një institucion që nuk ka ndoshta ndonjë rëndësi pse është rizgjedh, mua po më duket jo serioze mos po del jashtë mandatit të institucionit arsimor.

Argjend Thaqi: Ju falënderoj përfkëtë personalitetin e dhënë në këtë pikë të rendit të ditës. Kush është përmiratimin e kërkësës nr.11/265 datë:12.03.2024, përfkëtë personalitetin e parselës përfkëtë personalitetin e qëndrueshme që nuk ka plotësim të fotokopjeve me toner në shkollat e komunës së Malishevës, që përfshinë furnizimin e gjithë institucionet në nivel të Republikës.

fshatin Bellanicë?

Me vota unanime të 24 anëtarëve prezent kjo pikë kalon.

Kalojmë tek shqyrtimi i kërkesave. Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Çdo seancë që po mbajm po kemi këso raste që po na bëjnë mu ndi shumë keq. Një kërkesë është me datë: 28.09.2023 ka ardhur para 6 muajve kërkesë me rast cancer. 6muaj ditë mos me mbërrit kërkesa në seancë kjo nuk është shumë në rregull, sepse kërkesat e tillë në momentin si të protokolohen pranohen prej administratës me automatizëm duhet me u derzu tek Komiteti tek zyra e kryesuesit dhe zvarritja kaq e madhe për 6 muaj mua po më duket për me të ardh keq. Kryesues kisha kërku që rastet e tillë çdo herë jepju prioritet sepse sëmundja nuk pret.

Argjend Thaqi: Alban dhe të tjerat nuk i ke përcjellë mirë sepse shumë kërkesa ka pasur 3-4-5 muaj mirëpo ne jemi dëshmitar që në mbledhjet e fundit kemi futur raste të fëmijëve.

Kush është për miratimin e kërkesës nr.02/466 datë:28.09.2023 në shumën prej 1500E për trajtim shëndetësor?

18 anëtarë prezent me vota unanime miratohet kjo kërkesë

Kush është për miratimin e kërkesës nr.02/619 datë:29.12.2023 në shumën prej 1500E?

18 anëtarë prezent me vota unanime miratohet kjo kërkesë

Kush është për miratimin e kërkesës nr.02/84 datë:14.02.2024 në shumën prej 1500E?

Me vota unanime të 18 anëtarëve miratohet kjo pikë.

Kalojmë në pikën tjetër Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar dhjetor për vitin 2023.

Urdhëro, drejtore!

Blerim Thaqi: Përshëndetje për të gjithë!

Pas asaj që keni miratuar si buxhet në vlerën prej 18,124,837.00E dhe duke shtuar të gjitha ato të hyrat vetanake dhe pjesët tjera nga gjobat në komunikacion dhe gjobat nga gjykatat si total i viti 2023 buxheti ka mbërrit vlerën 20,224,430.60. Në KPF, kemi përmendur dhe qështjen e rritjes së të hyrave vetanake që planifikim fillestar ka qenë rritja e te hyrave prej 167%, ndërsa pas kërkesës për aprovimin e rritjes së kufirit të të hyrave vetanake për shumën prej 600.000E ato janë hyrë si pjesë e planifikimit të buxhetit dhe si total i buxhetit i bie 111%, pra kemi një tejkalim prej 11%.

Mbledhjen e lëshojnë grupei nga Nisma Social Demokratike.

Argjend Thaqi: Shkojmë në pauz 5 minuta.

Kthimi pas pauzës. Për shkak të mungesës së kuoromit këtë seancë e mbylli. Faleminderin për prezencën!

Përfundoi në ora: 12:10.

Procesimbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina





